



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.961/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Prizrenit, ndaj debitorit NTSHP IS Company BI me NUI 80484666 me seli ne Prizren, bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.2591/22 të datës 10.05.2023, me datën 18.09.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prizrenit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, KPPP.nr.2591/22 të datës 10.05.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor Pnr.432/19 të datës 25.06.2021, i lëshuar nga Përmbaruesi Privat.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te anulohet, dhe te kthej çështjen ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në baze të faturave të listuar në aktvendimin e ankimuar dhe propozimin për Urdhër përmbarrimor. Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor Pnr.432/19 të datës 25.06.2019, i ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat t'i paguaj shumën 21,000.08€, si dhe shpenzimet procedurës përmbarrimore.

Kundër urdhrin përmbarrimor debitori ka paraqitur prapësim debitori me pretendimin që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor.

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkalles së parë, me aktvendimin e ankimuar, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas shikimit të shkresave të lëndës gjykata vlerësoi përshtatshmërinë e dokumentit të besueshëm / Faturës së datës 30.05.2019, me nr. serik 2019000041 me përshkrimin: 05-360/05-0076484/19 – Borxhi i akumuluar “Fatura” në emër të qirasë për tregun Ortakoll-1 në vlerë 21’000.08 € (njëzet e një mijë euro e tetë cent), dhe gjeti se ky dokument është lëshuar për një borxh të akumuluar ndër vite, pa periudhë përcaktuar të akumulimit të borxhit, i cili borxh nuk ka bazë ligjore për t’u kërkuar nga Kreditori sepse Debitori IS Company nuk ka qenë fare shfrytëzues i tregut në Ortakoll. Këtë fakt Gjykata e vërtetoi në bazë të Njoftimit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prizrenit, datë 17.09.2013 - Ref. 495/2013, në të cilën thuhet se “NTSH IS Company” shfrytëzues i hapësirës së tregut Ortakoll-1 si qiramarrës në bazë të kontratës së datës 31.08.2011, lirohet nga pagesa e qirasë mujore për periudhën 01.06.2012 – 01.08.2013 (data e përfundimit të kontratës) në shumën 14’000.00€ (katërmëdhjetë mijë euro) pasi që në këtë periudhë tregu ka qenë në shfrytëzim të Andi (Skender) Krasniqi nga Fshati Caralluk – Komuna e Malishevës. Për pjesën tjetër të borxhit e cila është kërkuar me faturë nga ana e Kreditorit / diferenca në lartësinë e përgjithshme 21’000.08€, Debitori i çështjes është thirrur në institutin e parashkrimit. Pretendimin e Debitorit për parashkrim të detyrimit, Gjykata e trajtoi si të bazuar konform dispozitës nga neni 355 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, me të cilin përcaktohet se: “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite.”, pasi që borxhi i kërkuar daton / është akumuluar para datës 01.06.2012 ndërkaq kreditori propozimin për përmbarrim e ka parashtruar me 25.06.2019.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në

dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit pasi që edhe gjykata e shkallës së dytë i pranon ne tersi konstatimet e dhëna në vendimin e atakuar me të cilin është konstatuar se fatura e datës 30.05.2019, me nr. serik 2019000041 me përshkrimin: 05-360/05-0076484/19 – Borxhi i akumuluar “Fatura” në emër të qirasë për tregun Ortakoll-1 në vlerë 21’000.08 € (njëzet e një mijë euro e tetë cent), dhe gjeti se ky dokument është lëshuar për një borxh të akumuluar ndër vite, pa periudhë përcaktuar të akumulimit të borxhit, i cili borxh nuk ka bazë ligjore për t’u kërkuar nga Kreditori sepse Debitori IS Company nuk ka qenë fare shfrytëzues i tregut në Ortakoll. Këtë fakt Gjykata e vërtetoi në bazë të Njoftimit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prizrenit, datë 17.09.2013 - Ref. 495/2013, në të cilën thuhet se “NTSH IS Company” shfrytëzues i hapësirës së tregut Ortakoll-1 si qiramarrës në bazë të kontratës së datës 31.08.2011, lirohet nga pagesa e qirasë mujore për periudhën 01.06.2012 – 01.08.2013 (data e përfundimit të kontratës) në shumën 14’000.00€ (katërmëdhjetë mijë euro) pasi që në këtë periudhë tregu ka qenë në shfrytëzim të Andi (Skender ) Krasniqi nga Fshati Caralluk – Komuna e Malishevës

Ndërsa sa i përket predimeve lidhur me parashkrimin gjykata vlerëson se me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077 shprehimisht përcaktohet se: *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike), qofshin ato kërkesa periodike akcesore, siç janë kërkesat e kamatës, apo kërkesa periodike të atilla në të cilat përfundon vetë e drejta, siç janë kërkesat e ushqimit, parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë.”*

Ndërsa sa i përket pretendimeve lidhur me parashkrimin gjykata vlerëson se me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së shprehimisht përcaktohet se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, ndërsa në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale pasi që borxhi për periudhën para datës 01.06.2012, në shumë prej 21’000.08€, është parashkruar në kuptim të dispozitës së lartcekur pasi që ka skaduar afati brenda të cilit mund të kërkohet përmbushja e detyrimit ndaj kreditorit. Andaj edhe qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë mbi aprovimin e prapësimit të debitorit është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të kreditorit rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.961/23, me datë 18.09.2023

Gjyqtari,  
Ramush Bardiqi